REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 266 Prot. Tiranë, më datë 22.05.2026

VENDIM
Nr. 190, datë 22.05.2026

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 "*Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë*", neni 38, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 "*Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale*", Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 "*Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj*", pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 22.05.2026:

VENDOSI

1. Miratimin e Raportit të potencialit arkeologjik hartuar në kuadër të projektit "*Zgjerimi i rrugës së Ksamilit*", Ksamil, Bashkia Sarandë, me zhvillues **"Autoriteti Rrugor Shqiptar"**;
2. Investitori duhet të lidhë akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve për *"Zgjerimi i rrugës së Ksamilit"*, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Projekti dhe Raporti HIA të përcillen për mendim në UNESCO;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
5. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Blendi GONXHJA

SEKRETAR
Endri HAXHIU

Adresa: Rr. "Gëzim Erebara", Kinostudio, Tiranë, Shqipëri,
Email: info@iktk.gov.al; www.iktk.gov.al